

FORMULARI TIP I

Date: 01.11.2018

**NJOFTIMI PËR INFORMIM NGA KËRKUESI PRANË AGJENCISË
KOMBËTARE TË MJEDISIT/AGJENCISË RAJONALE TË MJEDISIT DHE NJQV
KU DO TË KETË VENDODHJEN INSTALIMI PËR APLIKIM PËR TU PAJISUR
ME LEJE MJEDISI TË INSTALIMIT TË TIPIT A OSE B / NDRYSHIME NË
FUNKSIONIMIN E INSTALIMIT TË TIPIT A DHE B**


Bazuar në Ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", Ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e Mjedisit", Ligjin Nr. 60/2014, datë 19.6.2014 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar dhe VKM 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja", Kreu VI "Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B", pika 2, Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

1. Informacion nëse kërkesa do të jetë për "Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B" apo "Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B": NDRYSHIM NE FUNKSIONIMIN E INSTALIMIT TE TIPIT "B"
2. Të dhënat e ekstraktit të QKR-së: "JLDQIN" Shpk, NUIS: K31618007S
3. Adresën e vendodhjes së instalimit: Zona minerare 147/5, Objekti Fushë-Lopë
Kraçtë Martanesh, Dibër
4. Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim: MINIERE NENTOKESORE
PER NJXJERRJET E KROMIT, NJXJERRJE E MINERACEVE ME SHFRYTEZIMIN
NË NIVELIN E KARBONIT (KARIERE)
5. Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues; QIELL TE HAPUR (KARIERE)
6. Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkuftar, kur kërkohet procedura e VNM-së në CD;
7. Konsultimet ndërkuftare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi; _____
8. Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen; AKM, sipa VKM Nr. 419, datë 25.06.2014
9. Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit;
info@akm.go.al

Mbaj përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 CD/DVD

Kërkuesi/Përfaqësuesi i shoqërisë

(ARBEN LISI)



Nr.kontakti

0682090472



PERSHKRIM I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

Ndyshim ne Funksonimin e Instalimit

Leje Mjedisi Tipi B PN-1045-10-2015

Minierat nentokesore dhe veprimtarite e lidhura me to. Nxjerrja e mineraleve, nga minierat me shfrytezim ne qiell te hapur (karriere)

(Fushe Lope, Zona Minerare 147/5, Bashkia Bulqize, Qarku Diber)

“YLDON” Sh.p.k.

1. Qellimi i Projektit te propozuar

Subjekti "YLDON" Sh.p.k., eshte i pajisur me Leje Minerare per shfrytezim te mineralit te kromit, me PN-1169-11-2015, leshuar nga QKL, dhe me Akt Miratimi Leje Shfrytezimi Nr. 1778, date 09.11.2015 leshuar nga Ministria e Energjise dhe Industrise, per siperfaqe te lejuar te Zones Minerare 3.984 km².

Megjithse shoqeria ke bere punimet pregatitore ne keto vite te fillimit te aktivitetit, kerkimet dhe punimet mierare nuk kane arritur te gjejne trupin e mineralit te kromit ne cilesien dhe sasine e duhur qe te justifikojte investimet e metjeshme.

Per kete arsye, Shoqeria "YLDON Sh.p.k, ka paraqitur prane autoritetit perkates Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise, kerkesen per zgjerim te koordintave te shfrytezimit nentokesor te kesaj miniere.

Per shkak te nevojave te aktivitetit te shfrytezimit, shoqeria "YLDON" Sh.p.k., ka filluar prane Minsitrise se Infrastruktures dhe Energjise proceduren per Zgjerimin e Lejes Minerare Nr.1778, date 09.11.2015. Ministria e Infrastruktures dhe Energjise me Shkeresn nr, 3229/5, date 18.09.2018, ka njoftuar fillimin e procedurave per zgjerimin e lejes minerare nga 3.984 km², ne 6.583 km².

Projekti I propozuar ka per qellim shfrytezimin e vendburimit te kromit ne zonen minerare nr.147/5, objekti Fushe Lope, Bulqize , Diber me punime te kombinuara siperfaqesore dhe nentokesore duke perdorur nje burim me rezerva te mjaftueshme ne gjendje qe te perkrah zhvillimin ekonomik te shoqerise dhe te permiresoje gjendjen ekzistuese te lendeve te para.

Nga studimi rezulton se vendburimi perbehet nga nje zone e mineralizuar me zhvillim dhe dalje ne siperfaqe. Mineralizimi eshte i trupit magnokromit dhe ka keto sasi rezervash:

$C1 + C2 = 32\ 200$ ton me permbajtje te $Cr_2O_3 = 30\%$.

Zona qe kerkohet per shfrytezim kishte nje siperfaqe prej 3.98km², dhe me zgjerimin e bere 6.583 km².

Mineralizimi kromitik i vendburimit ne vetvete nga pikepamja mineralogjike perbehet nga kromshpineliti i tipit magnokromit, i vendosur ne trajten e pikezimeve te rralla, mesatare apo brezave ne nje ambient dunitik qe si mineral kryesor ka olivinen dhe me pak serpentine.

Duke qene se minerali i kromit ne objektin Fushe Lope eshte me cilesi rreth 30% Cr_2O_3 ne bllok(pra ne nentoke), ne nxjerrje cilesia e tij shkon rreth 26-27% Cr_2O_3 .

Pra lind nevoja e perpunimit te metejsheem te tij , ne menyre qe te rritet vlera e shitjes se tij ne treg.Perpunimi i tij fillon qe ne sheshin e depozitimit te mineralit ,duke e seleksionuar me kujdes mineralin dhe duke e ndare kokren +70 me vete, ndersa cakullin dhe pluhurin me vete, sepse nuk mund te ndahet me dore cakulli nga pluhuri.

Pas ketij procesi, pra pasi eshte hequr guri plotesisht, minerali dergohet ne Fabriken e Pasurimit ku mbas perpunimit ne fabrike kthehet ne koncentrat me cilesi 46-48% Cr2O3, 48-50% Cr2O3.

2. Vendndodhja e projektit

Objekti i kromit Fushe Lope ndodhet prane vendburimeve 10 Korriku dhe Liqeni i Sopeve. Zona ndodhet rreth 3 km larg ne vije ajrore ne veri-lindje te minieres se Batres dhe rreth 10 km nga qyteti i Krastes. Qendra me e madhe e banuar eshte qyteza e Krastes qe ndodhet rreth 5 km larg ne vije ajrore ne jugperendim te objektit. Zona e kerkuar per shfrytezim ndodhet ne harten ne shkalle 1:25 000 me nomenklature K-34-89-D-a (Ternova) dhe kufizohet nga koordinatat e meposhteme . Zona qe kerkohet per shfrytezim ze nje siperfaqe prej **6.583 km²**,siperfaqja e cila do te shfrytezohet me punime siperfaqesore eshte **1 ha** (ne total per te 3 karierat).

Koordinatat e pikave qe kufizojne Zonen e Zhfrytezimit, leja Minerare Nr.1778/1


Zona 1, S=0.129 km²		
Pika Nr.	X	Y
1	4590333	4439302
2	4590332	4439370
3	4590217	4439446
4	4589993	4439578
5	4589992	4439618
6	4589991	4439650
7	4589750	4439775
8	4589655	4439728
9	4589655	4439700
10	4589638	4439364
11	4589770	4439350
12	4589850	4439540

Zona 2, S=0.158 km²		
Pika Nr.	X	Y
1	4591184	4440460
	4590920	4440462
	4590910	4440290
	4590750	4440290
	4590750	4440500
	4590934	4440890
	4591132	4440816

Zona 3, S=

Pika Nr.	X	Y	Pika Nr.	X	Y
1	4588632	4440988	17	4590771	4439450
2	4588640	4440418	18	4590776	4439716
3	4588704	4440400	19	4590906	4439684
4	4588800	4440400	20	4590950	4439900
5	4588800	4440373	21	4591213	4439890
6	4589340	4440220	22	4591184	4440460
7	4589655	4439728	23	4591132	4440816
8	4589655	4439700	24	4591125	4441000
9	4589620	4439000	25	4590925	4441000
10	4588391	4438959	26	4590418	4441835
11	4587945	4438988	27	4590650	4442000
12	4587946	4437900	28	4591000	4441500
13	4590164	4437753	29	4591000	4442059
14	4590242	4438495	30	4590266	4442059
15	4590660	4438505	31	4590266	
16	4590660	4439450			

Leja Minerare Nr.1778/1



MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
 DREKTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E MINIERAVE DHE INDUSTRISE
 OBJEKTI "Fushë Lopë", Qarku Dibrë

Kordinatat

Leja nr. Leja Nr.1778/1
 Subjekti "VLON" sh.p.k
 Minerali Krom
 Lloji i lejes Shfrytëzimi
 Sipërfaqja, km² 6.583

data 14.09.2018
 firma *[Signature]*
 Neritan Aleks

Zona 1, S = 0.129 km ²			Zona 2, S = 0.158 km ²		
X	Y	Z	X	Y	Z
4590333	4439302	+1600m e poshtë	4591184	4440460	+1550m e poshtë
4590332	4439370	+1600m e poshtë	4590920	4440462	+1550m e poshtë
4590217	4439446	+1600m e poshtë	4590910	4440290	+1550m e poshtë
4589993	4439578	+1600m e poshtë	4590750	4440290	+1550m e poshtë
4589992	4439618	+1600m e poshtë	4590750	4440500	+1550m e poshtë
4589991	4439650	+1600m e poshtë	4590934	4440890	+1550m e poshtë
4589750	4439775	+1600m e poshtë	4591132	4440816	+1550m e poshtë
4589655	4439728	+1600m e poshtë			
4589655	4439700	+1600m e poshtë			
4589638	4439364	+1600m e poshtë			
4589770	4439350	+1600m e poshtë			
4589850	4439540	+1600m e poshtë			

Pika	X	Y	Pika	X	Y
1	4588632	4440855	17	4590771	4439450
2	4588640	4440418	18	4590776	4439716
3	4588704	4440400	19	4590906	4439684
4	4588800	4440400	20	4590950	4439900
5	4588800	4440373	21	4591213	4439890
6	4589340	4440220	22	4591184	4440460
7	4589655	4439728	23	4591132	4440816
8	4589655	4439700	24	4591125	4441000
9	4589620	4439000	25	4590925	4441000
10	4588391	4438959	26	4590418	4441835
11	4587945	4438988	27	4590650	4442000
12	4587946	4437900	28	4591000	4441500
13	4590164	4437753	29	4591000	4442059
14	4590242	4438495	30	4590266	4442059
15	4590660	4438505	31	4590266	4440843
16	4590660	4439450			

PLANIMETRIA E PERGJITHSHME E GALARIVE TE REJA NR.1.2 DHE NR.3 ME KUFIJTE E ZONES MINERARE

SH. 1 : 5 000



INSTITUTI QENTROKOMBEDAR I GJYKIMIT

Organizata shtetërore e kërkimit për
matimin e saktësi të llojeve të
matimit të llojeve të matimit.
Shkurtimi: I.G.K.

V.B. Irvani - Llogaritës i Jeps Matimor

Personat e përgjithshëm të punës nënshkruar
duhet të kenë nënshkrim të punës.


Personat: V.B. Irvani, A. D. D. D.
Punëtor: I.G.K. (Shkurtimi i llojeve të matimit)


Niveli	Data	Skala	Titulli
1	14.000	1:5000	14.000
2	14.500	1:5000	14.500

14.000 14.500 14.500 14.500

SH.1 : 500

PRERIA GJATESORE A - A V.B. FUSHE LOPE



		
V.B. FUSHE LOPE		V.B. FUSHE LOPE
PRERIA GJATESORE A - A		PRERIA GJATESORE A - A
SH.1 : 500		SH.1 : 500
17.50m		17.50m
17.70m		17.70m
2.50m		2.50m
2.50m		2.50m
12.50m		12.50m
1510		1510
1490		1490

Koordinatat e galerive

Nr.		X	Y	Z	Seksioni i Galerise
1.	Galeria 1	4590363	4438560	1500m	S=5.2m ²
2.	Galeria 2	4590304	4438664	1500m	S=5.2m ²
3.	Galeria 3	4590460	4439237	1500m	S=5.2m ²

Siperfaqja ku do te zhvillohet aktiviteti eshtë një reliev tepër I aksidentuar sidomos në pjesën periferike të konturit (në VP, V, L) të rajonit. Rajoni kap kuota nga 1200m deri në 1998m mbi nivelin e detit. Vlen të vecojmë këtu Majën e Kacilit (1955), Majën në Jug të Majës së Kacilit me lartësi absolute (1989.9), Maja në VL të Liqenit të Duricve ne lartësi (1936m), Mali I Lopës me lartësi 1983, Maja e Grefës (1959m), Maja e Gjatë (1884.3m).

Toka e kerkuar per aktivitet minerar eshte prone shteterore. Aktualisht perdoret nga banoret e zones kryesisht per kullote. Krahas shfrytezimit te mineralit te kromit me punime te kombinuara siperfaqesore dhe nentokesore ne mbyllje te aktivitetit zona e shfrytezuar me kariere siperfaqesore, portalet e punimeve nentokesore dhe shesh depozitimet e sterileve do te rehabilitohet, do te gjelberohet dhe sistemohet duke i dhene nje pamje panoramike te kenaqeshme per syrin e njeriut dhe ne habitat per zhvillimin e flores dhe faunes se zones.

Rrjeti rrugor është I zhvilluar. Përmendim rrugën automobilistike Bater- Lugu I Gjatë dhe Bater –Fushë Lopë e cila funksionon gjatë gjithë vitit (përrjashtuar bllokimet nga bora gjatë dimrit) si dhe rruga sezonale nga Lugu I Gjatë ne Ternove, Lugu I Gjatë-Theken.

3. Informacion per qendrat e banuara

Popullsia e kesaj zone i perket nje zone rurale dhe merret kryesisht me pune bujqesore, blegtorale nje pjese e vogel eshte e punesuar ne objekte te ndryshme minerare qe jane ne aktivitet ne kete zone. Ata banojne ne fshatrat per'rreth. Qendrat me te aferta te banuara jane fshatrat Gjon ,Kotaj, Peshk, Lene si dhe ne qytezen e Kraste. Kjo qyteze u ngrit ne vitin 1970 Ne vitin 1987 ne qytezen e Krastes u ndertua e funksionoj fabrika e pasurimit te kromit. Nje pjese e mire e popullsisë punon ne emigracion dhe kryesisht ne Greqi. Popullsia e pergjitheshme e fshatrave te siperpermendur eshte rreth 4200 banore.

Zona ndodhet rreth 3 km larg ne vije ajrore ne veri-lindje te minieres se Batres dhe rreth 10 km nga qyteti i Krastes. Perfshihet nen juridiksionin e Bashkise Bulqize, Qarku Diber. Qyteti i Bulqizës filloi të ndërtohej me fillimin e punës, për nxjerrjen e kromit ne vitin 1948. Më pas, ditë pas dite e vit pas viti, u rrit kjo minierë, e bashkë me të edhe qyteti i Bulqizës, duke marrë përmasa më të mëdha e rëndësi të veçantë për ekonominë e Shqipërisë. Bulqiza u vendos në anën jugore të Fushës së Vajkalit, në krah të rrugës automobilistike që vjen nga Tirana e Burreli dhe shkon në Peshkopi e Dibër të Madhe. Qyteti rrethohet nga male të lartë, që në anën jugore është mali i Muriqit, ku gjëndet masivi më i madh i mineralit të kromit, në lindje Mali i Kacilit, në anën veriore është Mali i Bregut, në perëndim është Mali i Thanës. Qyteti

i Bulqizës është i vendosur 750 m mbi nivelin e detit, 152 km larg nga Tirana e 51 km nga Peshkopia. Qyteti i Bulqizës ka një popullsi sot prej 14000 banorë.

4. Skica dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektit


Ne këto aktivitete nuk do të ketë objekte industriale prandaj nuk do të trajtojmë struktura themelesh, konstruksione, e tjera se ato nuk ekzistojnë. Në objektin "Fushë Lope" hapja, përgatitja dhe shfrytëzimi i trupit nr.1 Fushë Lope dhe trupit nr.1 në Lugun e Gjatë, do të bëhet nëpërmjet galerive që do të hapen të reja, Galeria Nr.1 dhe Galeria Nr.2 do të hapen rreth 1.5 km në dalje të Batres dhe galeria nr.3 do të hapet afër Lugut të Gjatë.

Shfrytëzimi me karriere për trupin nr.11 në Fushë Lope do të bëhet që në vitin e parë nga ku do të shfrytëzohen rreth 11 200 ton krom me cilësi rreth 33%.

Objekte të tjera që do të ndërtohen në shërbim të aktivitetit janë:

-Objektet e shërbimit si zyrat, të shërbimit të punonjësve si banje, garderobe, dhoma të ndihmes së shpejtë, këto objekte do të jenë kontoniere me sanduic të mobiluar, të cilët do të vendosen në bazamente të ngritura nga toka trare me lartësi mbi 40cm.

SKICA E SHESHIT TË KANTJERIT



Kabina e furnizimit me energji elektrike.

Zona furnizohet me energji elektrike nepermjet linjes 10 KVA/370VA, nga nenstacioni i Batres. Subjekti ne marreveshje me OSHEE ne zbatim te legjislacionit Shqiptar do te furnizohet me energji elektrike nga kjo linje duke nderhyre me nje lidhje te re, do te ndertoje kabine transformimi dhe panel shperndarje te energjise per te furnizuar objektet e sherbimit dhe ndricimin.

5. Pershkrimi i procesit te shfrytezimit perfshire kapacitetin prodhues, sasia e lendeve te para dhe produkti perfundimtare

Radha dhe drejtimi i shfrytezimit.

Mbeshtetur ne vendndodhjen e ketyre rezervave, shfrytezimi ne bllokun e shfrytezimit do te jete nga kufiri per ne qender .

Sistemi i shfrytezimit

Ne rastin konkret do te kemi dy lloje sistemesh shfrytezimi, sistemin e shfrytezimit me qiell te hapur(kariere) per shfrytezimin e trupit nr.11 Fushe Lope dhe sistemin me galeri n/kati per trupin nr.1 ne F.Lope dhe trupin nr.1 ne L.Gjate.

Menyra e propozuar e shfrytezimit

Per te gjykuar dhe percaktuar drejt menyren e shfrytezimit te kromit ne zonen minerare te kerkuar, jane marre ne konsiderate:

- Kushtet e pergjitheshme si dhe topografia dhe klima e zones ne te cilen ndodhet objekti qe parashikohet ti nenshtrohet shfrytezimit.
- Hidrologjia, hidrogeologjia dhe hidrografia e zones ne te cilen kufizohet objekti i shfrytezimit
- Gjendja, ne pergjithesi e infrastruktures se rajonit dhe te zones se objektit , mundesite e permiresimit te saj, ndertime dhe instalime te tjera te domosdoshme per shfrytezimin e objektit nga pikpamja minerare.
- Materiali gjeologjik baze lidhur me ndertimin gjeologjik te rajonit dhe vendburimit, sasine dhe cilesine e rezervave gjeologjike dhe te shfrytezueshme brenda kufijve te percaktuar te shfrytezimit.
- Te dhenat lidhur me qendrushmerine e shkembenjve qe ndertojne objektin si dhe te trupave xeherore te konkretizuar ne te si dhe punimeve te ndryshme minerare te pergatitjes dhe shfrytezimit.
- Kerkesat e ndryshme per makineri, pajisje, instalime dhe investime te tjera per pergatitjen dhe shfrytezimin e objektit .
- Llojet e produkteve te prodhuara ne sasi dhe cilesi, trajtimi i tyre si dhe tregu i shitjes se tyre dhe çmimet.

Elementet e sistemit te shfrytezimit me galeri n/kati:

- **Gjatesia e bllokut te shfrytezimit 50 ml**
- **Trashesia e trupit 1÷ 2,5 m**
- **Gjatesia ne renie e trupit 25 ml**

- Lartesia e nenkatit 4-6 m
- Seksioni i galerise se nenkatit 3,6 m² (1.8 x 2.0 m)
- Largesia mes hinkave te shfrytezimit 6 m
- Gjatesia e traversave te hinkave 3-4 m
- Seksioni i oxhakeve te hinkave 1.44 m² (1.2 x 1.2 m)
- Seksioni i traversave te hinkave 2.6 m² (1.6 x 1.6 m)
- Rezerva ne bllok - ton Cr₂O₃


Rrëzimi i mineralit do te behet me bira minash me diameter 42 mm dhe me gjatesi qe do te luhatet nga 1-1.5 m deri ne 3-4 m.

Konsumi specifik i lendes plasese mbeshtetur ne eksperiencen e minierave te kromit do te jete rreth 0.25 kg/ton mineral. Transporti i mineralit nga frontet e shfrytezimit ne sipërfaqe do te behet me krahe ne distance 500 m dhe vagona vetshkarkues 0,63 m³.


Elementet e sistemit te shfrytezimit me kariere


- Lartesia e shkalleve 10 m
- Gjeresia e sheshit te punes 10-15 m me shume
- Gjeresia e transhese se poshteme 4-6-8 m
- Kendi i skarpates se shkalles 65-70°
- Gjeresia e shesheve te sigurise 3 m
- Ngarkimi dhe transporti te mekanizuar
- Rrezimi i sterilit dhe mineralit me eskavator
- Zbulimi ditor 45 m³
- Prodhimi ditor i mineralit 1.3 ton
- Rendimenti per dite pune direkt ne prodhim 1 ton/dite pune
- Rendimenti per dite pune direkt ne zbulim 7 m³/dite pune

SISTEMI I SHFRYTEZIMIT ME GALERI NENKATI



SISTEMI I SHFRYTEZIMIT ME GALERI NENKATI E PUNIME FUSHORE PLOTESUESE





Zgjedhja e menyres se shfrytezimit me punime siperfaqesore apo nentokesore, argumentimi i saj.

Per te gjykuar dhe percaktuar drejt menyren e shfrytezimit te objektit ne zonen minerare te kerkuar, jane marre ne kosiderate :

- Sasia e pergjitheshme e rezervave nxjerrshme te mineralit te kromit
- Sasia e pergjitheshme e shkembit steril per zbulim
- Koeficienti i zbulimit
- Topografia shume e pershtateshme e relievit te siperfaqes per te aplikuar menyren e shfrytezimit me qiell te hapu
- Karakteristikat gjeomekanike te shkembinjeve jane me vlere mesatare prandaj lejojne kushte te mira pune e te sigurta.
- Lidhja e objektit minerare me rrugen nacionale

Marrja ne analize te ketyre faktoreve bene te pershtateshme hapjen dhe shfrytezimin e ketij vendburimi me nentoke per trupin nr.1 te F.Lopes dhe trupin nr.1 te L.Gjate, ndersa trupi nr.11 do te shfrytezohet me kariere.

6. PROGRAMI I HOLLESISHEM I SHFRYTEZIMIT

Per te gjykuar me drejt per percaktimin e variantit optimal te menyres se hapjes e te venies ne shfrytezim te rezervave gjeologjike te vleresuara me lart e te pa marra u morren parasysh te gjithë faktoret gjeologo-topografik e tekniko- minerare qe ndikojne ne kete drejtim. Duke u nisur nga terreni ku shtrihet vendburimi i kromit, pozicioni i vendosjes se trupit dhe thellesia nga sipërfaqia e tokes del se :

Ne objektin “Fushe Lope” hapja ,pregatitja dhe shfrytezimi I trupit nr.1 Fushe Lope dhe trupit nr.1 ne Lugun e Gjate , do te behet nepermjet galerive qe do te hapen te reja, Galeria Nr.1 dhe Galeria Nr.2 do te hapen rreth 1.5 km ne dalje te Batres dhe galeria nr.3 do te hapet afer Lugut te Gjate, ndersa shfrytezimi i turpit nr.11 Fushe Lope do te behet me karriere.

Gal.nr.1 qe eshte galeria kryesore e objektit ,do te hapet ne kuoten

Z .1500 m, ne piken me koord.

X= 45 90 363

Y= 44 38 560

Gjatesia L=990 m

me pjerresi 5m per 1000m

Seksioni I galerise do te jete S = 5.2 m²

Furnele ajrimi do te hapen ne cdo 150 m

Gal.nr.2, qe eshte galeria e ajrimit per galerine Nr.1 do hapet ne kuoten

Z=1540 m ne piken me koord.

X= 45 90 304

Y= 44 38 664

Gjatesia e gal. 2 L= 2300 m

pjerresia 5 %

Seksioni do jete S=5.2 m²

edhe ne kete galeri per arsye ajrimi do te hapen furnele ajrimi

Gal.nr.3 qe do te jete galeria e ajrimit per galerine Nr.2 , do te hapet ne kuoten

Z=1570m ne piken me koord.

X =45 90 460

Y =44 39 237

me pjerresi 5%

Gjatesia e Gal.3 do te jete L=1650 m

Seksioni S=5.2 m²

Ritmi I avancimit ne te tre galerite, parashikohet te jete rreth 20m/Muaj.Ne zonen Bater – F.Lope ne 1 vit mund te realizohen rreth 150 dite pune per arsye te dimrit te gjate.

Ne vitin e pare do te hapet galeria 1 dhe galeria 2 qe do te ecin paralelisht , ne vitin e dyte do te hapet edhe galeria 3.

Galerite e parashikuara duhet te perfundojne brenda 16 vjeteve.

Per arsye ajrimi,galerite do te lidhen me njera tjetren me fornele ne cdo 150m, per te zgjidhur problemet me ajrimin e frontit.

Pasaportat teknike te hapjes dhe armatimit te punimeve te hapjes, pregatitjes dhe

shfrytezimit me nentoke.


Sic e thame me lart galerite kryesore do te hapen me seksion $S=5.2m^2$ dhe ne zona tektonike , ne kryqezim punimesh do te perdoret armatim druri ose metalik sipas kushteve dhe sipas udhezimit te drejtuesit Teknik.

Bashkengjitur jane pasaportat teknike te hapjes , te armatimit dhe te shfrytezimit

PUNIM KRYESOR KAPITAL $S=5.2m^2$


PRERJA A-A (VERTIKALE)

Shkalla 1 : 50



PRERJA B-B (HORIZONTALE)

Shkalla 1 : 50



Ritmi I avancimit 26 ml ne muaj, numri I birave 13, seksioni I galerise $5.2 m^2$, numri I kapsollave 13-15, sasia e fitilit 31 ml, dispozicioni I birave “pyke vertikale”, gjatesia e bires 1.6 ml, koeficienti I shfrytezimit te bires 0.9, 1-2-3-4-5 birat e prerjes , 6-7-8-9-10-11-12-13 birat e konturit.

Shfrytëzimi me karrierë siguron realizimin e një kostoje më të ulët se shfrytëzimi me punime nëntokësore. Në zgjedhjen e sistemit të shfrytëzimit me karriere janë marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:

1. Kushtet tekniko minerare të objektit.
2. Mënyra e ngarkimit, transportit dhe depozitimit të sterilit.
3. Mënyra e kryerjes së punimeve të zbulimit.
4. Mënyra e ngarkimit të transportit brenda dhe poshtë karrierës
5. Mjetet e shpimit, ngarkimit, transportit që do të parashikohen të përdoren për këtë qëllim.
6. Mënyra e rrëzimit të shtresës së mineralizuar

Bazuar për sa me sipër sistemi i shfrytëzimit që do të parashikohet të përdoret është i thjeshtë me transport të sterilit deri në 2km edhe depozimin e sterilit brenda karrierës, që do të grumbullohen do të sistemohen për mbushje të zonës së shfrytëzuar gjatë viteve të fundit të aktivitetit dhe për rigjenerimin e mjedisit.

Kapaciteti prodhues dhe jeta e minieres

Kapaciteti minimal prodhues i minieres do të jetë 3000 ton/vit dhe jeta gjatësia e minieres do të jetë për aq vite sa do të përcaktohet edhe në Lejen Minerare

Sigurimi teknik në proceset e punës për hapjen, shfrytëzimin dhe administrimin e objektit

Gjate ushtrimit të aktivitetit minerar subjekti duhet të mbajë parasysh që problemet e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë janë me të rëndësishmet dhe me të mëprehta dhe kërkojnë vlerësim serioz .

Para se gjithash në të gjitha operacionet do të punesohen specialiste me eksperiencë punë në kryerjen e proceseve të ndryshme të karakterit minerar. Drejtuesi teknik i punimeve para fillimit të punës do të zbatohet rregullat dhe normat e përcaktuara në Rregulloren e Teknikes së Sigurimit për Minierat dhe Karrierat të Vitit 1999 të hartuar nga Instituti i Teknologjisë Nxjerrëse dhe Përpunuese të Mineraleve të miratuar me urdher të Ministrit Nr 132 date 07.04.1999 , mbështetur në nenin 17 të Ligjit Minerar Shqipëtar Nr 7796 date 17.02.1994.

Regulloret e Teknikes së Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik të punimeve dhe subjektit, do të zbatohet në çdo proces punë të përcaktuar në plan- organizimin e kryerjes së punimeve të hartuar nga ai dhe të miratuar nga drejtuesit e firmes.

- Plan organizimi i punimeve do të hartohet para fillimit të punimeve
- Plan organizimi i punës hartohet nga drejtuesi teknik i punimeve
- Drejtuesi teknik i punimeve ose personi i ngarkuar do të bëjë kontrollin teknik dhe azhurnimin e saktë të punimeve minerare të çdo lloji për të cilat subjekti ka marrë license
- Rradha e kryerjes do të përcaktohet hollesisht në planin e masave tekniko-organizative dhe do të miratohet nga pronari i shoqërisë
- Në këtë plan tekniko-organizativ masat e teknikes së sigurimit do të zënë vendin kryesor.

- Drejtuesi teknik i punimeve do te kryeje instruksione te rregullta mujore e tre mujore , ku do te trajtohen tema te vecanta per te gjitha profesionet.
- Punonjesit qe do te punojne ne nentoke te sigurojne frontet e punes nga blloqet e varura, minat e paplasura si te vendosin armatim kur kerkohet dhe do te testohen cdo tremujor kundrejt firmes.
- Kujdes i vecante do te tregohet ne krijimin e kushteve te punes

7. Informacion per infrastrukturen e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion per ruget ekzistuese te aksesit apo nevojen per hapje te rrugeve te reja.


Zona furnizohet me energji elektrike nepermjet linjes 10 KVA/370VA, nga nenstacioni i Batres. Subjekti ne marreveshje me OSHEE ne zbatim te legjislacionit Shqiptar do te furnizohet me energji elektrike nga kjo linje duke nderhyre me nje lidhje te re, do te ndertoje kabine trasformimi dhe panel shperndarje te energjise per te furnizuar objektet e sherbimit dhe ndricimin. Ne keto kushte mund te themi se infrastruktura per lidhjen me rrjetin elektrik eshte e ngritur, ekzistuese.

Ne teknologjine e shfrytezimit te mineralit te kromit me miniere nentokesore nuk perdoren sasi te madhe uji.

Uji do te perdoret ne periudhe te thate per lagjen e rrugeve te levizjes se mjeteve te

transportit, dhe territorit te karrieres dhe per sherbime vetiake nga personeli sherbimit ne miniere, si dhe gjate shpimit te birave per lendet plasese ne punimet nentokesore. Sasia e ujit do te jete minimale rreth 10 m³ ne dite. Uje do te sigurohet me depozita nga shoqeria.

Ujrat e ndotura nga pluhurat e krijuara do te depozitohen ne vaskat e ndertuara ne sheshin e zones qe eshte marr per shfrytezim. Praktikisht do te ndertohen dy vaska me keto parametra: gjatesi 6m, gjeresi 3m dhe thellesi 2m. Uji i ndotur do te shkarkohet ne nje vaske dhe pasi te mbushet me llumra, ujrato kalojne ne vasken tjeter. Ujrat largohen nga vaska pasi te jene ngurtesuar dhe depozitohen ne sheshin e caktuar. Vaskat rrethohen me lartesi deri 2m me rrjet metalike te qendrueshme per u mbrojtur nga renia e njerzeve ne to dhe per te menjanuar aksidentet ne pune. Ujerat e pastra pas vaskave do te riperdoren ose do te shkarkohen



ne perroin ne afersi te vendburimit. Theksojme qe keto ujera nuk permbajne elemente kimik ndotes.

Mbetjet sterile

Zona ne te cilen do te vendoset sheshi i depozitimi te mineralit te kromit eshte ngjitur me ishsektorin minerar Lugu i Gjate prane kantierit te ri qe do te ndertoje shoqeria.

Ndersa per sterilin jane percaktuar dy sheshe depozitimi, poshte galerise 1 dhe poshte galerise 3, ku shpati eshte teresisht i zhveshur dhe nuk shkatrojmë asgje ne mjedis.

Me perfundimin e aktivitetit minerar, do te rehabilitohen plotesisht sheshet e depozitimeve se bashku me portalet e punimeve nentokesore, dhe shkallet e karieres siperfaqesore. Keto sterile nuk shkatrojne ndotje te tokes ne sheshin ku depozitohen sepse kane te njejten perberje mineralogjike. Gjithashtu mbetjet e krijuara nga veprimtaria humane e punonjesve ose nga proceset e punes do te trasportohen ne sheshin e depozitimit te miratuar nga pushteti vendor.

Per menaxhimin e mbetjeve te cilat gjenerohen gjate procesit te punes bazuar ne ligjin 10463 date 22.09.2011 investitori do te zbatoj kete praktike pune e cila eshte pasqyruar edhe ne planin e rehabilitimit.

Ne dy portalet e galerive 1 dhe 3 do te krijohet nje shesh depozitimi me siperfaqe 2840 m², ku do te depozitohen sterilet.

Investitori lidhur me permiresimin e eficenses se perdorimit te sterileve, ne fazen e pare sterileve do te sistemohen ne shesh depozitimin e projektuar dhe ne vazhdimesi 50-60 % do te perdoren per shtrimin dhe mirembajtjen e rrugeve hyrese per ne miniere, rrugeve te zones qe lidhin komunitetin perreth dhe rehabilitimin e shkalleve te karieres.

Ne faze te dyte qe eshte faza e shfrytezimit keto sterile do te rikthehen ne miniere per te mbushur hapesirat e shfrytezimit qe do ti sherbejne investitorit per shfrytezimin maksimal te rezervave te mineralit te kromit dhe mbrojtjen e minieres nga shembjet qe mund te jene burim aksidenti.

Theksojme se keto sterile jane inerte me perberje mineralogjike te njejte me depozitimet e terrenit ku kryhen punimet, prandaj nuk demtojne faunen dhe floren e zones.

Lidhur me ndikimet negative nga perdorimi i burimeve theksojme:

Burimet qe i vijne ne ndihme zhvillimit te aktivitetit te shfrytezimit jane:

1- energjia elektrike qe perdoret

-per kompresoret e prodhimit te ajrit te komprimuar, per shpimin e birave ne frontet e punes

- elektrovozet per transportin e vagonave te sterilit dhe mineralit te kromit,

-ventilator te ajrimit te galerive

2- lenda plasese e cila perdoret per copetimin e shkembit, ne sasine 0.25 kg / ton mineral

Ne rastin konkret energjia elektrike nuk ka ndikime negative ne mjedis sepse eshte burim i paster energjie po keshtu edhe lenda plasese e perdorimit civil jane prodhime te teknologjive te fundit bashkohore te cilat ne procesin kimik digjen plotesisht dhe nuk emetojne lende helmuese ne toke dhe ne ajer.

Ne mbyllje te aktivitetit ne zbatimit te akteve ligjore dhe Urdherit te Ministrit nr.302 date 12.04.2011 " Per hartimin e planit te rehabilitimit te mjedisit, planit te veprimtarive te mbylles se veprimtarise minerare , te menyres se percaktimit te zones se rrezikshme te nje te drejte minerare dhe planit te menaxhimit te mbetjeve

minerare, si dhe urdherit nr. 383 date 20.05.2011 " Per miratimin e formes dhe permbajtjes se planit te veprimtarive per mbylljen e nje veprimtarie minerare' te cilat jane ne zbatim te ligjit minerar nr.10304 date 15.07.2010, eshte hartuar edhe plani i rehabilitimit te zones qe do te shfrytezohet.

Infrastruktura ekzistuese

Rrjeti rrugor është i zhvilluar. Përmendim rrugën automobilistike Bater- Lugu I Gjatë dhe Bater –Fushë Lopë e cila funksionon gjatë gjithë vitit (përfshirë bllokimet nga bora gjatë imrit) si dhe rruga sezonale nga Lugu I Gjatë ne Ternove, Lugu I Gjatë-Theken. Objekti lidhet me rruge automobilistike te paasfaltuar, kategoria e peste, me Batren . Per hapjen , pergatitjen dhe shfrytezimin e rezervave te vendburimit eshte e nevojshme te ndertohen ne fillim rruga. Per kete nga rruga egzistuese Bater –F.Lope do te hapen rruget e reja ne drejtim te kantierit te punes dhe hyrjeve te galerive. Kantieri i punes, ku perfshihen: zyra e punes, magazina , do te ndertohen ne ish sektorin e minieres Lugu i Gjate.

Rruga e re qe do te hapet deri te Galeria Nr.1 ka gjatesine L=300m me gjeresi 4 m, rruga e re qe do te hapet deri te Galeria Nr.2 ka gjatesine L=480m me gjeresi 4 m ndersa rruga per tek Galeria Nr.3 ka gjatesine L=170m me gjeresi 4 m.

- 8. Programin per shfrytezimin , kohezgjatjen e shfrytezimit , kohezgjatjen e planifikuar per funksionimin e projektit, kohen e mundshme te perfundimit te funksionimit te projektit dhe sipas rastit edhe fazen e planifikuar te rehabilitimit te siperfaqes pas mbarimit te funksionimit te projektit.**

Punimet e ndertimit per venien ne shfrytezim te minieres jane:

- Ndertimi brenda teritorit te zones se marr per shfrytezim te rrugeve per hapjen e galerive nr.1,2 dhe 3.
- Vendorsja e objekteve ndihmese te sherbimit qe do sherbejne si zyra, magazina.
- Ndertimi i linjes se furnizimit me energji elektrike te objektit te sherbimit

Ne objektin "Fushe Lope" hapja ,pregatitja dhe shfrytezimi I trupit nr.1 Fushe Lope dhe trupit nr.1 ne Lugun e Gjate , do te behet nepermjet galerive qe do te hapen te reja, Galeria Nr.1 dhe Galeria Nr.2 do te hapen rreth 1.5 km ne dalje te Batres dhe galeria nr.3 do te hapet afer Lugut te Gjate, trupi nr. 11 do te shfrytezohet me punime siperfaqesore.

Gal.nr.1 qe eshte galeria kryesore e objektit ,do te hapet ne kuoten

Z .1500 m, ne piken me koord.

X= 45 90 363

Y= 44 38 560

Gjatesia L=990 m

me pjerresi 5m per 1000m

Seksioni I galerise do te jete S = 5.2 m²

Furnele ajrimi do te hapen ne cdo 150 m

Gal.nr.2, qe eshte galeria e ajrimit per galerine Nr.1 do hapet ne kuoten

Z=1540 m ne piken me koord.

X= 45 90 304

Y= 44 38 664

Gjatesia e gal. 2 L= 2300 m

pjerresia 5 %

Seksioni do jete $S=5.2 \text{ m}^2$ edhe ne kete galeri per arsye ajrimi do te hapen furnele ajrimi

Gal.nr.3 qe do te jete galeria e ajrimit per galerine Nr.2 , do te hapet ne kuoten

Z=1570m ne piken me koord.

X =45 90 460

Y =44 39 237

me pjerresi 5%

Gjatesia e Gal.3 do te jete L=1650 m

Seksioni $S=5.2 \text{ m}^2$

Ritmi I avancimit ne te tre galerite, parashikohet te jete rreth 20ml/Muaj.Ne zonen

Bater –F.Lope ne 1 vit mund te realizohen rreth 150 dite pune per arsye te dimrit te gjate.

Ne vitin e pare do te hapet galeria 1 dhe galeria 2 qe do te ecin paralelisht , ne vitin e dyte do te hapet edhe galeria 3.

Galerite e parashikuara duhet te perfundojne brenda 16 vjeteve.

Per arsye ajrimi,galerite do te lidhen me njera tjetren me fornele ne cdo 150ml, per te zgjidhur problemet me ajrimin e frontit.

Pasaportat teknike te hapjes dhe armatimit te punimeve te hapjes, pregatitjes dhe shfrytezimit me nentoke.

Sic e thame me lart galerite kryesore do te hapen me seksion $S=5.2 \text{ m}^2$ dhe ne zona tektonike , ne kryqezim punimesh do te perdoret armatim druri ose metalik sipas kushteve dhe sipas udhezimit te drejtuesit Teknik.

Program pune per perpunimin e mineralit

Duke qene se minerali i kromit ne objektin Fushe Lope eshte me cilesi rreth 30% Cr_2O_3 ne bllok (pra ne nentoke), ne nxjerrje cilesia e tij shkon rreth 26-27% Cr_2O_3 .

Pra lind nevoja e perpunimit te metejsheem te tij , ne menyre qe te rritet vlera e shitjes se tij ne treg.

Perpunimi i tij fillon qe ne sheshin e depozitimit te mineralit ,duke e seleksionuar me kujdes mineralin dhe duke e ndare kokren +70 me vete, ndersa cakullin dhe pluhurin me vete, sepse nuk mund te ndahet me dore cakulli nga pluhuri. Pas ketij procesi, pra pasi eshte hequr guri plotesisht, minerali dergohet ne Fabriken e Pasurimit ku mbas perpunimit ne fabrike kthehet ne koncentrat me cilesi 46-48% Cr_2O_3 , 48-50% Cr_2O_3 .

Raporti i perpunimit krom koncentrat behet sipas formules se meposhtme:

$$Q_{\min} \times \% \text{Cr}_2\text{O}_3 \times \text{lag.}_{\min} = Q_{\text{konc}} \times \% \text{Cr}_2\text{O}_3 \times \text{lag.}_{\text{conc}}$$

Ku; Q_{\min} - Sasia e mineralit qe do te perpunohet

$\% \text{Cr}_2\text{O}_3$ -perqindja e kromit te minerali

lag.min - koficienti i lageshtise se mineralit qe merret mesatarisht 4%

lag.conc - koficienti i lageshtise se koncentratit qe merret mesatarisht 7%

Meqense ne afersi te zones minerare ndodhet nje fabrike pasurimi, nuk eshte e nevojshme ndertimi i nje objekti te tille per perpunimin e mineralit, pasi e perpunojme ne fabriken ne afersi te zones.

Kapaciteti prodhues dhe jeta e minieres

Prodhimi i mineralit te kromit u projektua duke patur ne konsiderat keto kerkesa:

- 1-Sasine e pergjithshme te rezervave te vendburimit te mundshme per shfrytezim.
- 2- Kushtet tekniko-minerare te vendburimit.
- 3- Kerkesat e investitorit per mineral kromi

Kapaciteti minimal prodhues i minieres do te jete 3000 ton/vit dhe jetegjatesia e minieres do te jete 25 vjet si do te percaktohet ne Lejen Minerare.

Ajrimi i minieres

Ajri i paster ne objekt do te futet nga galeria 1, e mbas ajrosjes se fronteve do te vazhdoje

rrugen mbrapsht ne 150m e para deri sa te hapen fornelet e ajrimit.

Mbas lidhjes se forneleve ajri do te qarkulloje nepermjet forneleve te ajrimit sipas sezonit. Deri ne gjatesine prej 150m ballet e galerive do te ajrosen me ventilator, fuqia e

te cilit llogaritet ne baze te sasise se ajrit qe nevojitet ne front

*Llogaritja e sasise se nevojshme te ajrit. **Sasia e ajrit e nevojshme sipas numrit te punetoreve***

rezulton :

$$Q = K \times n \times q = 2 \times 4 \times 4 = 32 \text{ m}^3/\text{min} = 0,533 \text{ m}^3 / \text{sek};$$

Ku :

Q - sasia e ajrit e nevojshme

k - koeficienti i humbjeve ne rrjet 2

n - numri i punonjesve njeheresh ne nentoke =4

q- sasia e ajrit per punonjes 4 m³/min

Furnizimi me ajer te ngjeshur. Sipas organizimit te punes, ne miniere parashikohet te punohet ne dy fronte, pra do te jene ne pune vetem dy çekiçe shpues me nga 3.5 m³ ajer ne minute. Pra sa me siper nevojat per ajer te ngjeshur do te jene per 8 m³/minute. Per furnizimin me ajer te ngjeshur te pajisjes se shpimit do te duhet nje motokompresor me prodhimtari 10 m³/min, i cili eshte vendosur tek hyrja e galerise.

9. Menyrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve te projektit

Ne kete aktivitet nuk do te kete objekte industriale prandaj nuk do te trajtojme struktura themelesh, konstruksione, e tjera se ato nuk ekzistojne.

Objektet e sherbimit si zyrat, te sherbimit te punonjesve si banje, garderobe, dhome te ndihmes

se shpejte, keto objekte do te jene kontoniere me sanduic te mobiluar, te cilet do te vendosen ne bazamente te ngritura nga toke trare me lartesi mbi 40cm.

10. Lendet e para qe do te perdoren per shfrytezimin dhe menyra e sigurimit te tyre (material ndertimi, uje dhe energji)

Ne teknologjine e shfrytezimit te mineralit te kromit nuk perdoren lende te para ne sherbim te aktivitetit, prandaj nuk do ta trajtojme. Theksojme se ne miniere nuk do te perdoren lende te demshme (toksike) qe po te shkarkohen ne uje, ajer dhe toke ndotin ambientin dhe demtojne floren dhe faunen e zones.

Makinerit qe do te perdoren ne miniere jane me motor dizel, ato punojne me nafte dhe lubrifikohen me vajra. Gjithashtu punonjesit do te jene instruktuar si te veprojne ne rast se ndodhin rrjedhje aksidentale te vajrave nga sotokarteri i makinave ne rast avarish. Ne keto raste gjithë materiali ndotur do te mblidhet dhe do te transportohet ne sheshet e caktuara nga pushteti vendor.

Per hapjen dhe ndertimin e rrugeve per ne galerite nr.1,2 dhe 3, ndertimin e linjes elektrike dhe shfrytezimit te mineralit te kromit me punime te kombinuara sipërfaqesore dhe nentokesore do te perdoren makinerit, si: cekic pneumatik, eskavator, kamione transporti me motora dizel qe punojne me karburant (Dizel).

Karburanti do te furnizohet nga subjekte te licencuara per import, ruajtje dhe tregtim te karburanteve ne republiken e Shqiperise. Ndersa per mbrojtjen nga pluhuri, per nevoja vetiake dhe nga punonjesit, mbrojtjen nga zjarri dhe sherbime te tjera do te perdoret uje. Uje do te sigurohet me depozita nga shoqeria.

Objektet e sherbimit do te jene konstruksione te lehta sanduici qe do te merren te gatshme nga subjekte te specializuara.

Lendet e para ndihmese qe do te perdoren per shfrytezimin e mineralit te kromit jane:

- Nafte dhe Vajra lubrifikant per mjetet
- Energjia elektrike per ndricim dhe objektin e sherbimit
- Panele Sanduici
- Lende plasese te perdorimit civil dhe materiale plasese ne dite, te cilat do te sigurohen nga subjekte te licensuara.

11. Informacion per lidhjet e mundshme te projektit me projekte te tjera ekzistuese prane zones se projektit

Ne afersi te zones e cila do te shfrytezohet per nxjerrjen e kromit gjendet nje fabrike pasurimi. Sasite e mineralit te kromit qe do te nxirren nga shoqeria do te shkojne ne kete fabrike pasurimi per perpunim te metejshem. Perpunimi i kromit fillon qe ne sheshin e depozitimit te mineralit, duke e seleksionuar me kujdes mineralin dhe duke e ndare kokren +70 me vete, ndersa cakullin dhe pluhurin me vete, sepse nuk mund te ndahet me dore cakulli nga pluhuri.

Pas ketij procesi, pra pasi eshte hequr guri plotesisht, minerali do dergohet ne Fabriken e Pasurimit ku mbas perpunimit ne fabrike kthehet ne koncentrat me cilesi 46-48% Cr₂O₃, 48-50% Cr₂O₃. Prodhimi i kromit mbas nxjerrjes nga nentoka, del si produkt i gatshem per t'u tregtuar ne Fabrike te Pasurimit, i cili ne blloqet gjeologjike ka permbajtje rreth 30% te Cr₂O₃, kurse mbas nxjerrjes si prodhim i gatshem ka permbajtje mbi 26 % te Cr₂O₃. Prandaj prodhimi i siguruar ne kete miniere do te

perpunohet ne fabriken e pasurimit, pasi eshte e nevojshme, per te rritur vleren e shitjes per eksport.

Shoqeria nuk do te ndertoje objekt te saj in per te perpunuar prodhimin e mineralit, pasi ne zone nuk plotsohen kushtet per ndertimin e ketij objekti, por do te bashkepunoje me nje shoqeri perpunuese te mineralit te kromit qe ndodhet ne afersi te zones.

12. Informacion per alternativat e marra ne konsiderate persa I takon perzgjedhjes se vendodhjes se projektit dhe teknologjise qe do te perdoret

Theksojme per organet vendim marrese, se mundesia e alternativave te marra ne konsiderat per perzgjedhjen e vendodhjes se projektit nga subjektet minerare ne teresi jane ne nivelin zero per keto arsye:

- Zona minerare dhe objekti percaktohet nga MEI me propozim te AKBN dhe shpallet ne planin tre vjecar dhe nji vjecar te Ministrise.

- Investitoret qe kryejne aktivite minerare jane para nje fakti te kryer per pjesmarrje ne tender te zonave minerar te shpallura per konkurim.

Subjekti "YLDON" shpk ka marre pjese ne konkurimin e zhvilluar ne MEI per perfitimin e te drejtes per aplikimin ne QKL per Leje minerare shfrytezimi per zonen minerare nr. 147/5 dhe ne daten 16/07/2015 me shkresen me Nr 4757/2 Prot eshte njoftuar nga MEI si fitues i ketij konkurimi dhe ka fituar te drejten e pergatitjes se dokumentave perkatese per pajisjen me leje minerare shfrytezimi ne zonen konkruuese Nr 147/5. Eshte zgjedhur kjo zone duke qen se konsiderohet si nje vendburim me rezerva te konsiderueshme te mineralit te kromit.

Per shfrytezimin e ketij vendburimi, pjese e procedures eshte edhe aplikimi prane Ministrise se Mjedisit per proceduren e thelluar te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (*aktiviteti perfshihet ne Shtojcen 1 Kodi 19*)

13. Te dhenat per perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit perfshire sasite e ujit te nevojshem, te energjise, lendeve djegese dhe menyren e sigurimit te tyre.

Ky aktivitet eshte aktivitet shfrytezimi i cili konsiston ne nxjerrjen e mineralit te kromit pra nuk perdor lende te para por siguron lende te pare sic eshte minerali i kromit. Uji perdoret vetem ne rastet per lagjen e territorit ne menyre qe te mos kete krijim te pluhurave gjate veprimtarise sidomos ne kohe te thate dhe me ere, si dhe gjate shpimit te birave, kjo sasi uji sigurohet perms depozitave te ujit qe shoqeria siguron per kete qellim. Perdorimi i tij do te jete minimal rreth 10 m³ uje ne dite. Lenda djegese qe perdorin mjetet e transportit sigurohet ne pikat e furnizimit me karburant, te licensuara per tregtimin e ketyre lendeve. Lenda plasese qe do perdoret do te sigurohet nga subjekte qe e tregtojne dhe jane te licensuara, sasia e perdorimit te saj parashikohet te jete 0.25kg /ton mineral. Duke qen se sasia e mineralit te kromit parashikohet 3000 ton/vit ateher sasia e lendes plasese sipas llogaritje do te jete 750 kg/vit.

14. Aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit si ndertim I kampeve apo rezidencave etj.

Ngritja e kantierit

Kantieri I kesaj miniere te re do te ngrihet sic e kemi thene me lart, ne ish sektorin e minieres se Batres qe quhet Lugu I Gjate. Ne kete kantier do te vendosen objektet e sherbimit te cilat do te jene konstruksione te lehta sanduici qe do te merren te gatshme nga subjekte te specializuara dhe do te sherbejne si zyra magazine etj. Persa I perket sigurimit te fjetjes se punetoreve do te realizohet ne qytezen e Krastes.